



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	05.07/2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Plisat”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrollloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesë përmes emailit zyrtar nga tifo grupi “Plisat” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike me datë 05 Korrik 2021 deri më 31 Korrik 2021 dhe vendosjen e një tende në sheshin “Skënderbeu”. Qëllimi i kërkesës është mbajtja e një peticioni për vendosjen e shtatores së heroit kombëtar “Adem Jashari”.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e një tende në sheshin “Skënderbeu” me datë 05 Korrik 2021 deri më 31 Korrik 2021 për mbajtjen e peticionit nga tifo grupi “Plisat”.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.